



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.25

Prishtinë, më 25.11.2020, në orën 09:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Shkëmb Manaj, Dimal Basha, Artan Abrashi, Evgjëni Thaçi-Drăgush, Donika Kadaj-Bujupi, dhe Endrit Shala.

Munguan: Visar Hoti, Abelard Tahiri, Ljubinko Kraraxhiq dhe Alban Hyseni.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Shefki Kastrati, NDI; Hysni Demaku, RTK; Aulona Sylaj, Ekonomia Online; Agnesa Haxhiu, KDI; Agon Dreshaj, asistent; Blerim Sallahu, GP/LV; Alba Hondozi, SKV.

Stafi mbështetës i komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi Shkëmb Manaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Propozimi dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë me kandidatët për anëtarë dhe zëvendës-anëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës;
3. Njoftim me ftesën e Gjykatës Kushtetuese, adresuar kryetarit të komisionit për Legjislacion;
4. Diskutim lidhur me ndryshim-plotësimin e nenit 81 të Rregullores së Kuvendit;
5. Rishpallja e konkursit për zgjedhjen e 1 (një) anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile;
6. Të ndryshme.

1. Propozimi dhe miratimi i rendit të ditës

Donika Kadaj-Bujupi, propozoi që si pikë e parë në rend të ditës të jetë diskutimi për letrën e dërguar nga z. Malcolm Simmons, ish- kryetar i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, i përfaqësuar sipas autorizimit të dr. Artan Qerkini, avokat. Kjo letër e ardhur në Kuvendin e Kosovës, për shkak të peshës së temave, të cilat i ka radhitur z. Simmons, duhet të renditet si pikë e parë e rendit të ditës.

Kryetari theksoi se nëse anëtarët e komisionit vlerësojnë se duhet trajtuar kjo çështje, mund të futet në rend të ditës, por nëse vlerësohet se duhet përgatitje rreth kësaj letre, mund të mbetet për mbledhjen e radhës.

Endrit Shala, tha se pajtohet me propozimin e deputetes Donika Kadaj-Bujupi, që të trajtohet si pikë e parë e rendit të ditës, kur dihet tashmë se kjo shkresë ka ardhur në Kuvend në fund të korrikut. Më pas, kërkoi sqarim se pse kjo shkresë nuk është shpërndarë me kohë, duke marrë parasysh se ka ardhur nga ish- kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it dhe duke pasur parasysh pretendimet e tij të paraqitura në letër dhe kërkesën e tij që të flasë para deputeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Më pas, deputeti Shala propozoi që z. Simmons të ftohet dhe të dëgjohet nga Komisioni për Legjislacionin, pastaj varësisht nga deklaratat që ai jep në komision, të shikohet mundësia e propozimit që të formohet një komision hetimor.

Donika Kadaj-Bujupi, tha se ka kërkesë nga z. Simmons, ku thotë se është i gatshëm që të deklarohet dhe të japë informata të rëndësishme para Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe para komisionit, gjithashtu, informata këto që ndërlidhen me ndërhyrjet në hetimet penale, kërcënimet ndaj dëshmitarëve të mbrojtur etj. Në këtë drejtim, ajo tha se propozimi nga ana e saj duhet të hidhet në votim dhe të vendoset në rend të ditës diskutimi për këtë çështje.

Dimal Basha, tha se pajtohet që diskutimi i letrës së z. Simmons të futet si pikë e rendit të ditës.

Kryetari konstatoi se pikë e gjashtë e rendit të ditës, është kërkesa e avokatit Artan Qerkini, i cili përfaqëson z. Simmons, ish-kryetar i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it.

Kryetari konstatoi se miratohet rendi i ditës, me ndryshimet e propozuara.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë me kandidatët për anëtarë dhe zëvendësanëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës

Kryetari paraqiti para deputetëve emrat e propozuar për anëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, duke thënë se në bazë të ligjit, anëtarët e propozuar duhet të kenë dymbëdhjetë vite përvojë pune në sistemin e drejtësisë. Gjithashtu, ai tha se para propozimeve nga Qeveria kemi kërkesën e Odës së Avokatëve, drejtuar Kryetares së Kuvendit për mospërfshirjen e Odës së Avokatëve në këtë komision, por sipas propozimit të Qeverisë është vlerësuar që z. Dastid Pallaska është avokat dhe sipas kësaj edhe Oda e Avokatëve është e përfaqësuar. Më pas, tha se hap diskutimin sesi do të procedohet kjo çështje, të formohet një grup punues, që të vlerësohet përvoja e punës së të gjithë kandidatëve apo të përfundohet në këtë mbledhje.

Dimal Basha, u pajtua që të formohet një grup punues, në mënyrë që të vlerësohet nëse kandidatët e propozuar përmbushin kriteret sipas ligjit. Ai shtoi se duhet të shqyrtohet edhe shqetësimi nga Oda e Avokatëve. Në fund, z. Basha propozoi që nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar i grupit punues të jetë deputeti Alban Hyseni.

Artan Abrashi, tha se sa i përket letrës së Kryetares së Kuvendit, për mospërfshirjen e Odës së Avokatëve të Kosovës në Komisionin për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, dhe meqë u theksua nga kryetari i komisionit, që Dastid Pallaska përfaqëson Odën e Avokatëve, deputeti Abrashi kërkoi sqarim lidhur me këtë çështje, duke thënë se a ka ndonjë njoftim nga ana e personit në fjalë që i njëjti përfaqëson Odën e Avokatëve apo thjesht është vetëm vetiniciativë e tij, sepse Oda e Avokatëve ngrë shqetësim për mospërfaqësim, ndërkohë që u tha që i njëjti përfaqëson Odën e Avokatëve.

Kryetari, tha se z. Pallaska është avokat dhe nuk e përfaqëson Odën e Avokatëve, ndërsa sa i përket letrës së Odës së Avokatëve, ai tha se propozimet fillestare që janë adresuar nga Ministri i Drejtësisë në Qeveri, nuk ka pasur asnjë avokat të propozuar, ndërkohë nga konsultimet që kanë pasur në Qeveri, së

bashku me ministrin e Drejtësisë, ka ndryshuar lista, duke u plotësuar me një avokat, ndërsa shkresa që ka ardhur nga Oda e Avokatëve, është shkresë e ardhur para vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Donika Kadaj-Bujupi, kërkoi që të hidhet në votim propozimi i z. Basha, që të formohet një grup punues, në mënyrë që të analizohet përvoja e secilit kandidat. Gjithashtu, tha se ka nevojë që të bëhet një hulumtim shtesë për kandidatët, në mënyrë që të jemi në rregull edhe me Kushtetutën dhe respektimin e saj.

Dimal Basha, meqë u ngritën disa çështje këtu dhe duke pasur parasysh që ka kandidatë të cilët dyshohen për falsifikim të dokumenteve zyrtar, mendoj që grupi punues do të sqarojë shumë situata.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se për shqyrtimin e propozim-vendimit të Qeverisë, me kandidatët për anëtarë dhe zëvendësanëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, komisioni nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit të punues për shqyrtimin e propozim-vendimit të Qeverisë, me kandidatët për anëtarë dhe zëvendësanëtarë të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës.

1. Formohet grupi i punës në përbërje:

Visar Hoti- kryesues,
Evgjeni Thaçi- Dragusha, anëtare,
Alban Hyseni, anëtar,
Donika Kadaj- Bujupi, anëtare,
Endrit Shala, anëtar dhe
Ljubinko Karaxhiq, anëtar.

3. Njoftim me ftesën e Gjykatës Kushtetuese adresuar Kryetarit të Komisionit për Legjislacion;

Kryetari njoftoi anëtarët e komisionit me ftesën që i ka bërë Gjykata Kushtetuese, lidhur me rastin e ngritur nga Lëvizja Vetëvendosje, ku ka konsideruar se vendimi për themelimin e Qeverisë është kundërkushtetutës, pasi që z. Etem Arifi nuk ka pasur mandat dhe rrjedhimisht vota e tij është e pavlefshme. Në këtë seancë dëgjimore është ftuar edhe përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje, si parashtrues i kërkesës, përfaqësuesi i Qeverisë, Kryetarja e Kuvendit dhe kryetari i Komisionit për Legjislacion, prandaj prezenca ime në këtë seancë nuk është në emër të komisionit, por në cilësinë e kryetarit të Komisionit dhe vlerësimi im, por edhe i Kryetares së Kuvendit është vlerësim i deputetit, në bazë të funksionit. Pra, as Kryetarja e Kuvendit nuk përfaqëson në idenë e saj, Kuvendin, por as kryetari i komisionit nuk përfaqëson qëndrimin e secilit anëtar të komisionit.

Dimal Basha, meqë gjykata iu është drejtuar komisionit, konsideroj se nuk ka interes të dëgjohet vetëm kryetari i komisionit, por komisioni si tërësi, dhe duke pasur parasysh që komisioni përfaqësohet nga subjekte të ndryshme politike, duke pasur edhe bindje të ndryshme edhe rreth çështjes në fjalë, nuk mendoj se është mirë që kryetari i komisionit të paraqesë mendim para gjykatës. Pra, edhe si kryetar i komisionit, është mirë të refuzohet prezenca në këtë seancë dëgjimore, për arsye se si kryetar, në një formë, përfaqëson Komisionin për Legjislacion.

Kryetari, duke iu përgjigjur deputetit Basha, tha se në bazë të kësaj logjike, i bie që ftesën duhet ta refuzojë edhe Kryetarja e Kuvendit, sepse as Kryetarja e Kuvendit nuk përfaqëson 120 deputetë.

Dimal Basha, tha se nuk po flet për Kryetaren e Kuvendit, por po i referohet shkresës që është ftuar kryetari i Komisionit për Legjislacion.

Kryetari sqaroi se asnjëherë nuk e refuzon ftesën e Gjykatës Kushtetuese dhe të asnjë institucioni tjetër dhe në këtë seancë dëgjimore do të japë mendimin në cilësi të kryetarit të komisionit, në bazë të funksionit dhe si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, tha se duke ditur që Komisioni për Legjislacion ka refuzuar që të trajtojë këtë çështje, me arsyetimin se komisioni nuk është përmbarues i aktgjykimeve, nuk është në rregull që tani Komisioni për Legjislacion të japë mendim për një çështje që e ka refuzuar. Nga ana tjetër, ajo shtoi se nuk ka dyshime që z. Manaj do të japë mendim profesional, por megjithatë nuk mund të jetë përfaqësues i të gjithë deputeteve të komisionit, gjithashtu nuk mund të marrë pjesë as si deputet, sepse nuk është i ftuar si deputet, por as si kryetar i komisionit, sepse nuk e ka konsensusin e komisionit, prandaj në këtë drejtim nuk duhet që të jetë pjesëmarrës në këtë seancë dëgjimore fare.

Endrit Shala, tha se në momentin e konstituimit të Kuvendit, bëhet edhe konstituimi i komisioneve, pra kryetarët e komisioneve zgjidhen nga 2/3 e deputeteve, por kjo nuk nënkupton që kryetari përfaqëson mendimin e deputetëve brenda komisioneve, ndërsa për rastin në fjalë, theksoi se çfarëdo qëndrimi që do të jepet në seancën dëgjimore, është vetëm si qëndrim i deputetit Shkëmb Manaj dhe jo qëndrim i komisionit.

Artan Abrashi, duke iu referuar shkresës, tha se ftesa është bërë në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Legjislacion dhe meqë Komisioni për Legjislacion mbi bazën e Rregullores së Kuvendit është trupi përgjegjës për çështjen e mandatit të deputetëve, dhe meqë komisioni nuk ka trajtuar këtë çështje, atëherë kur është paraqitur kërkesa nga Kryetarja e Kuvendit, cili do të jetë qëndrimi si kryetar i Komisionit për Legjislacion, në këtë seancë dëgjimore pranë Gjykatës Kushtetuese, përndryshe edhe ideja e qëndrimit individual ose partiak sipas z. Abrashi është e papranueshme, sepse në komision ka mendime të kundërta.

Kryetari, në fjalën e tij, tha se komisioni ka trajtuar këtë çështje dhe në përgjigjen adresuar Kryetares së Kuvendit, përgjigjja e komisionit ka qenë se Komisioni për Legjislacion ka të drejtë të trajtojë mandatin e deputetit, vetëm në rastet kur deputeti mungon gjashtë muaj, pa arsye, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, prandaj edhe do ta paraqesë këtë qëndrim, në emër të komisionit.

Dimal Basha, në fjalën e tij të serishme, tha se z. Manaj nuk është i thirrur në cilësinë e deputetit dhe nuk mund të flasë si i tillë, prandaj qëndrimi i komisionit mund t'i dërgohet me shkrim Gjykatës Kushtetuese, dhe meqë nuk ka pajtueshmëri në komision, z. Manaj nuk mund të shkojë në këtë seancë dëgjimore. Më pas, ai propozoi që të hidhet në votim pjesëmarrja ose mospjesëmarrja e kryetarit të komisionit, në këtë seancë dëgjimore.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, tha se si grup parlamentar kemi pasur qëndrim neutral, karshi kësaj çështjeje, megjithatë do të ishte në rregull nëse komisioni do të kishte konsensus që pastaj kryetari të përfaqësonte komisionin, por në rastin konkret, ky konsensus nuk ekziston, prandaj konsideroj se nuk duhet të merrni pjesë fare.

Kryetari, tha se ftesa i është adresuar Kryetares së Kuvendit, në emër të Kuvendit dhe Komisionit për Legjislacion, për shkak të fushëveprimit të komisionit, prandaj nëse komisioni për këtë rast ka një qëndrim shtesë deri më datën kur duhet të paraqitemi në seancën dëgjimore, do të jem i gatshëm që ta prezantoj këtë qëndrim.

Kryetari, duke iu përgjigjur dilemave të deputetëve, tha se e ka paraqitur këtë shkresë para komisionit, vetëm për të qenë korrekt para anëtarëve të komisionit.

4. Diskutim lidhur me ndryshim-plotësimin e nenit 81 të Rregullores së Kuvendit

Kryetari, tha se gjatë punës në grup punues për Rregulloren e Punës së Kuvendit, është diskutuar edhe ndryshimi i nenit 81, me qëllim që të sqarohet procedura e miratimit të Rregullores së Kuvendit. Rregullorja aktuale e përcakton se Rregullorja miratohet sipas procedurës së ligjvënies, nëse e marrim parasysh procedurën e ligjvënies për Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Pra, dihet se këto i nënshtrohen vetëm një leximi, dhe në këtë drejtim, ideja ka qenë se a duhet edhe Rregullorja e Kuvendit t'i nënshtrohet vetëm një leximi?

Më pas paraqiti propozimin për plotësim-ndryshimin e nenit dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, nëse kanë diskutime lidhur me këtë çështje.

Donika Kadaç-Bujupi, tha se duke pasur parasysh specifikat e Rregullores, vonesën dhe pasojat që ka pasur Kuvendi, për shkak të mosmiratimit që dhjetë vjet, konsideroj që kjo do të ishte mënyra më e duhur që të kalojë kjo Rregullore.

Dimal Basha, tha se duhet diskutim edhe më tutje, prandaj kërkoi që kjo çështje të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Evgjeni Thaçi-Drangusha, kërkoi më shumë kohë, në mënyrë që ta shqyrtojnë këtë draft të amendamentit, që pastaj në mbledhjen e radhës të vijnë me qëndrime të qarta, lidhur me këtë çështje.

Endrit Shala, në lidhje me draftin e amendamentit, tha se është dakord me paragrafin 1, 2, 3 dhe paragrafin 4 pika a. Gjithashtu, tha se pajtohet me propozimin e parafolësve, që votimi të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Kryetari, meqë Rregullorja e kërkon shumicën e deputetëve, tha se pajtohet që duhet të ketë diskutime brenda grupeve parlamentare, lidhur me këtë çështje. Në këtë drejtim, ai tha se mbetet që në mbledhjen e radhës të bëhet teksti final i amendamentit të propozuar dhe të vazhdohet tutje.

5. Rishpallja e konkursit për zgjedhjen e 1 (një) anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile

Kryetari, tha se është hera e katërt që shpallet konkursi për anëtar të KPK-së nga radhët e shoqërisë civile dhe dështon, prandaj duhet rishpallur prapë. Në këtë drejtim, ai ftoi organizatat e shoqërisë civile, që merren me çështjet e drejtësisë, që të japin rekomandimet e tyre për kandidatët për anëtar në KPK, i cili do të përfaqësojë shoqërinë civile.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

V e n d i m

Rishpallet konkursi për zgjedhjen e 1 (një) anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile, siç përcaktohet me nenin 9, paragrafi 3.3 dhe nenin 10, paragrafi 3 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

6. Shqyrtimi i shkresës nga Malcolm Simmons, ish- kryetar i Asamblese së Gjyqtarëve të EULEX-it, përfaqësuar sipas autorizimit nga dr. Artan Qerkini, avokat

Kryetari, tha se kjo pikë e rendit të ditës ka të bëjë me një kërkesë, të cilën e ka përcjellë z. Artan Qerkini, avokat i autorizuar nga z. Malcolm Simmons, ish- kryetar i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, për kërkesë për hetim parlamentar. Ndërsa, sa i përket procedurës, ai tha se shkresa ka ardhur në Kuvend, në fund të muajit korrik, megjithatë shkresa është diskutuar me koordinatoren e komisionit dhe është vendosur që të renditet në një nga mbledhjet e radhës. Në këtë drejtim, ai tha se ka vërejtje për

administratën e Kuvendit edhe të komisionit, duke thënë se secila shkresë që vjen në emër të komisionit, brenda ditës, duhet të shpërndahet te të gjithë anëtarët e komisionit, sepse secili anëtar i komisionit ka të drejtë të bëjë propozime për rend të ditës. Më pas, për të sqaruar më shumë se pse nuk është shpërndarë kjo shkresë, kryetari Manaj fjalën ia dha koordinatorit të komisionit, z. Visar Krasniqi.

Visar Krasniqi, tha se shkresën e kemi pranuar në fund të korrikut, për të cilën ju kemi njoftuar menjëherë, si kryetar i komisionit. Po ashtu, jeni njoftuar se shkresa ka ardhur në mënyrë jo të rregullt, kur dihet se zakonisht shkresat me një peshë të tillë i adresohen Kryetares së Kuvendit apo Kryesisë së Kuvendit, pastaj Kryesia e delegon te trupat tjerë. Gjithashtu, në vazhdimësi, kjo shkresë ka qenë në pritje si pikë e rendit të ditës, të cilën nuk e keni radhitur ose e keni vlerësuar si prioritet tjetër.

Dimal Basha, meqë kryetari ka qenë në dijeni dhe në vazhdimësi kjo çështje ka qenë pikë në pritje e rendit të ditës dhe nuk është sjellë në komision për shqyrtim dhe duke ditur se kryetari është njëri nga të barabartët në komision, në këtë rast, fajin e bartë komplet kryetari i komisionit.

Kryetari, tha se ka ende shkresa, të cilat janë në pritje për shqyrtim në komision, që ende nuk janë trajtuar, edhe para shkresës në fjalë.

Dimal Basha, në fjalën e tij të sërishme tha se nëse ka shkresa që janë adresuar në komision dhe nuk jemi të njoftuar, është gabim shumë i madh. Më pas, duke u kthyer sërish në shkresën e z. Malcolm, ai kërkoi sqarim nga kryetari i komisionit, pse nuk është sjellë për trajtim në komision, por vazhdimisht është shtyrë kjo çështje.

Kryetari, duke u përgjigjur, tha se janë mbi dhjetë pika të cilat janë në pritje për rend të ditës dhe mbi këtë bazë bëhet vlerësimi i propozimit të rendit të ditës.

Dimal Basha, tha se nuk është në rregull që faji të bartet tek administrata, dhe meqë ka qenë në pritje në vazhdimësi, është dashur që nga kryetari të përcillet mesazhi tek administrata, që kjo shkresë të shpërndahet te të gjithë anëtarët e komisionit.

Evgjeni Thaçi-Drangusha, tha se letra e ardhur nga avokati i është drejtuar Komisionit për Legjislacion, për të cilën kryetari i komisionit ka qenë në dijeni dhe nuk ka marrë asnjë veprim. Pra, po të mos ishte Radiotelevizioni i Kosovës, ne si anëtarë të komisionit nuk do ta kishim kuptuar asnjëherë që kjo letër ekziston. Më pas, ajo potencoi se letra mban datën 27 korrik 2020 dhe është dashur që më 28 korrik të shqyrtohet me prioritet e jo të mbahet me muaj të tërë, pa u trajtuar.

Donika Kadaj-Bujupi, theksoi se së pari përgjegjësia është politike. Në këtë rast, si kryetar i komisionit, duke ditur që nuk bëhet fjalë për një letër të rëndomtë, por për një pretendim serioz nga një institucion i cili e ka pasur drejtësinë në dorë për vite të tëra në Kosovë, dhe në bazë të vendimeve dhe gjykimeve të kësaj drejtësie, shumë qytetarë të Republikës së Kosovës kanë përfunduar nëpër burgje. Në vazhdim, tha se në Kuvend ka pasur debate të gjata në lidhje me plot raste ku janë shkelur të drejtat e njeriut, ku ish-ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë mbajtur me vite të tëra në paraburgim dhe në fund janë shpallur të pafajshëm, duke mos marrë askush përgjegjësi për vitet që kanë humbur nëpër burgje. Duke iu referuar letrës se z. Simmons dhe çështjeve për të cilat ka shprehur gatishmëri për të dëshmuar, ajo tha se kryetari i komisionit ka shkelur ligjin, sepse me ligj është dashur që në momentin kur flitet që ka pretendime për dhjetëra shkelje nga ana e një institucioni, qoftë ndërkombëtar apo vendor, ka pasur obligim të raportojë dhe në këtë rast nuk është korrekte që për këtë letër nuk na ka njoftuar me kohë. Në fund, ajo propozoi që sa më parë nga komisioni, të ftohet z. Malcolm Simmons, të dëgjohet dhe të sqarohet njëherë se çfarë ka ndodhur përgjatë gjithë këtyre viteve.

Kryetari, duke iu referuar znj. Kadaj-Bujupi, tha se para diskutimit është mirë që të dihet për çka është fjala. Kjo është kërkesë për themelimit të Komisionit Hetimor Parlamentar dhe dihet se në bazë të ligjit, si themelohet një komision hetimor “neni 2.1 i Ligjit për Hetim Parlamentar, thotë që fusha e veprimit të

komisionit duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe dispozitat ligjore të së drejtës ndërkombëtare, duke mos cenuar pavarësinë dhe duke mos penguar veprimtarinë e organeve tjera”. Pra, kjo nënkupton që nuk mundet që Kuvendi i Republikës së Kosovës të themelojë Komision Hetimor Parlamentar, për të trajtuar çështjet që janë vendosur në organet e drejtësisë, sepse konsiderohet ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, theksoi se është krim fshehja e këtyre pretendimeve të z. Simmons, sepse me Kodin penal dënohem, nëse fshehim fakte.

Endrit Shala, meqë nga administrata u tha këtu se kjo letër nuk paska ardhur në mënyrë të rregullt, unë po them se nuk ka mënyrë më të rregullt se kur një gjyqtar i mirënjohur ndërkombëtar, një ankesë të tillë e dërgon në Komisionin për Legjislacion, me të gjitha pretendimet se kanë ndodhur dhe po vazhdojnë të ndodhin padrejtësi, ashtu siç edhe thuhet në letrën e tij, ku flet edhe për arsyet e krijimit të Gjykatës Speciale, mënyrën e punës së kësaj gjykate dhe qëllimin e krijimit të saj, pastaj edhe epilogun dhe mënyrën e veprimit të të njëjtëve gjyqtarë, ish- kolegë të tij, që tashmë janë duke punuar në Gjykatën Speciale. Po i njëjti gjyqtar, të njëjtin mision e ka paditur edhe në Gjykatën Evropiane. Po ashtu, i njëjti gjyqtar, të gjitha këto parregullsi i ka ngritur edhe në Gjykatën e Anglisë, ku edhe e ka fituar apelin për këtë rast. Pra, bëhet fjalë për një kryetar të Gjykatës, i cili tregon saktë sesi është dënuar rasti Drenica, tregon se pa kurrfarë prove janë dënuar vëllezërit Demaku, flet edhe për rastin Kiçina, pastaj tregon sesi janë ndjekur penalisht njerëzit që të ketë klimë të duhur për vazhdimin e dialogut Kosove-Serbi, pastaj ndjekja e njerëzve, në mënyrë që të eliminohen politikisht. Prandaj, duke parë gjithë këto pretendime, nuk mendoj se ka vend më të duhur se Kuvendi i Republikës së Kosovës, që të diskutohen këto çështje. Në fund, ai tha se është interes i qytetarëve të Kosovës dhe i Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjithashtu që Komisioni ta ftojë z. Simmons, dhe varësisht nga deklaratimet e tij, pastaj deputetët të ndërmarrin veprime, të cilat përcaktohen nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi, duke mos ndërhyrë në vendimet gjyqësore.

Donika Kadaj-Bujupi, duke iu referuar letrës së z. Simmons, konkretisht pikës 6, propozoi që në takimin e radhës, pikë e parë e rendit të ditës të jetë kërkesa e z. Simmons dhe ndërkohë administrata ta ftojë dhe ta njoftojë gjithashtu për gatishmërinë që të dëgjohet në komision. Më pas, znj. Kadaj-Bujupi iu drejtua z.Manaj, duke i thënë se nëse konsiderohet nga ana jote që eventualisht do të bëni shkelje, edhe pse është e kundërta, sepse tashmë ju keni bërë shkelje, duke mos na njoftuar me këtë shkresë, atëherë mund të tërhiqeni dhe nënkryetari i parë ta marrë përgjegjësinë, që ta udhëheqë këtë çështje.

Kryetari, tha se si pikë e parë, duhet t’i jepet epilog kërkesës për hetim parlamentar. Pra, në bazë të Ligjit për Hetim Parlamentar, 6 deputetë mund të marrin nismën, të nënshkruhet nga 40 deputetë, atëherë Kuvendi në mënyrë automatike është i obliguar të formojë Komision Hetimor Parlamentar, ndërsa çështja tjetër e ngritur nga deputeti Shala, ku kërkon që z. Simmons të ftohet në komision për raportim, z. Manaj theksoi se është i gatshëm që ta dëgjojë z. Simmons, por gjithmonë në pajtim me procedurat. Në vazhdim, sqaroi procedurat, duke thënë se avokati i z. Simmons duhet të bëjë një kërkesë të veçantë, e cila duhet t’i adresohet Kryetares së Kuvendit, ku Kryetarja njofton Kryesinë e Kuvendit, pastaj Kryesia adreson çështjen në Komisionin për Legjislacion.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, tha se duke qenë se kjo është çështje shumë e ndjeshme dhe duke pasur parasysh pretendimet e ngritura nga z.Simmons, propozoi që si pikë e parë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës të vendoset për këtë çështje.

Donika Kadaj-Bujupi, meqenëse i është drejtuar Komisionit për Legjislacion, jemi të obliguar që ta dëgjojmë, pastaj a themelohet Komisioni Hetimor apo jo, do ta vendosim pasi të dëgjohet z. Simmons.

Endrit Shala, në fjalën e tij të serishme, tha se administrata, nga sot, të kontaktojë me personin e autorizuar, për të shprehur vullnetin e Komisionit për Legjislacion, që ta dëgjojë z. Simmons, njëkohësisht, Kuvendi i Republikës së Kosovës, për shkak të interesit publik, të mbulojë të gjitha shpenzimet për ardhjen e z. Simmons në Kosovë.

Kryetari, tha se nuk e ka të qartë se çka mund të prodhojë Kuvendi dhe çka mund të ndihmojmë, pasi të dëgjohet dëshmia e z. Simmons?

Endrit Shala, duke iu përgjigjur kryetarit në dilemën e tij, tha se është interes publik të dëgjojen argumentet e z. Simmons.

Kryetari, tha se z. Simmons do të ftohet, por garantoj para mediave dhe para të gjithëve, që kjo çështje do të mbyllet pas seancës dëgjimore para komisionit.

Endrit Shala, tha se nuk mund të mbyllet kjo çështje, kur një gjyqtar i Eulex-it do të tregojë mënyrën dhe arsyen se Gjykata Speciale është formuar që të dëmtohet Kosova, politikisht, dhe t'i mbushin xhepat zyrtarët e Eulex-it. Kjo duhet të jetë me shumë interes edhe për opinionin publik.

Donika Kadaj-Bujupi, propozoi që të ftohet mbledhja e radhës sa më shpejt që është e mundur, me vetëm një pikë të rendit të ditës, kërkesa e z. Simmons për raportim në Komisionin për Legjislacion.

Kryetari, tha se meqë nuk ka kuorum dhe në mënyrë që t'i jepet epilog kësaj çështjeje, kjo pikë shtyhet për mbledhje të radhës.

7. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

**Kryetar i komisionit,
Shkëmb Manaj**
